



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 19, datë 06.03.2024

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 64, DATË 07.07.2020, VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 81, DATË 10.08.2020 DHE VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 55, DATË 26.06.2020 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, VKM-së nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendës Kryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.64 datë 07.07.2020, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 81, datë 10.08.2020 dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 55, datë 26.06.2020, për shtetë listës emërore të familjeve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit të shkaktuar.
2. Heqjen nga lista e dytë e subjekteve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që i është bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.64, datë 07.07.2020, të subjekteve si më poshtë vijon:

NR.	NR. RENDOR NE VKB 64	NR. APLIKIMI	EMËR	MBIEMËR	DS	EKSPERTIZA	VKB FITUES	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1	1123	14655	TAFIL	SELIMI	DS2	PRISHJE	VKB 64, datë 07.07.2020	KATUND I RI

3. Heqjen nga lista e dytë e subjekteve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që i është bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 81, datë 10.08.2020, të subjekteve si më poshtë vijon:

NR.	NR. RENDOR NE VKB 81	NR. APLIKIMI	EMËR	MBIEMËR	DS	EKSPERTIZA	VKB FITUES	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1	2240	60667	GEZIM	PISHA	DS3	PRISHJE	VKB 81, DT.10.08.2020	KATUND I RI

4. Heqjen nga lista e parë e subjekteve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që i është bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.55, datë 26.06.2020, të subjekteve si më poshtë vijon:

NR.	NR. RENDOR NE VKB 55	NR APLIKIMI	EMËR	MBIEMËR	DS	EKSPERTIZA	VKB FITUES	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1	5952	36349	HAXHI	GASHI	DS3	PRISHJE	VKB 55, DT 26.06.2020	KATUND I RI
2	5984	51669	NDUE	LLYCI	DS1	PRISHJE	VKB 55, DT 26.06.2020	KATUND I RI
3	5590	28469	NAIME	TUFA	DS3	PRISHJE	VKB 55, DT 26.06.2020	KATUND I RI



5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 07.03.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 162 /prot.
5

Durrës, më 13 03 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.19 datë 06.03.2024 “Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 64, datë 07.07.2020, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 81, datë 10.08.2020 dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 55, datë 26.06.2020 përsa i përket ndryshimit të listave emërore të familjeve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit të shkaktuar”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

